



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja: Nr. 31

Datë: 07. 05. 2024

Fillimi i takimit: Ora: 12:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë

Kryesoi: Kreshnik Radoniqi, Kryesues i KQZ

Anëtarët e KQZ-së prezentë: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj

Nga SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ; **Nga ZRCKFSP:** Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP; **Përkthyes:** Argjina Misini; Jehona Cami; **Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 27 dhe 28/2024
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për Kuvendin e Kosovës
4. Raport i Këshillave të KQZ
 - 4.1. Këshilli për Personel
 1. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e ekuivalencës së pagave të pozitive të reja të krijuara në KQZ.
 2. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e shtesës tranzitore.
5. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi: Sot, e kemi mbledhjen 31, dhe një agjendë ku në rend dite janë dy procesverbale 27 dhe 28, raporti për Kuvendin e Kosovës, miratimi i vendimit për caktimin e ekuivalencës se pagave të pozitave të reja të krijuara në KQZ, dhe Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e shtesës tranzitore. A ka ndonjë propozim, diçka tjetër...?

Burim Ahmetaj, tha se është përgatitur një rekomandim për ndërprerjen e mandatit të anëtarëve të KKZ-ve, kështu që propozojmë të jetë pikë e rendit.

Sami Kurteshi, falënderoi KQZ-në për shtyrjen e mbledhjes por ai njoftoi se takimi i Komitetit të Auditimit nuk u mbajt, ngase nuk kishte kuorum...

Ilir Gashi, pyeti se si mbeti pika 'shtesa tranzitore' ?

Kreshnik Radoniqi, tha se nuk jam duke e kuptuar këtë pikë, dhe pa e sqarue këtë pikë ne vendim nuk mund të marrim...por, e trajtojmë te këshilli për personel...

Me 10 vota për, u miratua rendi i ditës. Gjithashtu, u miratuan me 10 vota për edhe procesverbale 27 dhe 28/2024

2.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për Kuvendin e Kosovës:

Valmir Elezi, tha se 'sfidat dhe rekomandimet' e marra sipas shqyrtimet që kanë dalë, po edhe sipas propozimeve të z. Sami Kurteshi, ne i kemi inkorporuar ato në raport. Z. Elezi, i paraqiti 'plotësimet në raport' si 'sfida', 'rekomandime' në këtë mbledhje, si: "rekrutimet", "mos unifikimi i adresave", 'përfaqësimi ligjor i KQZ', 'ruajtja e materialeve në QNR', 'kontributi i KQZ në reformën zgjedhore', 'rekrutimet e reja në Sekretariat'...

Ilir Gashi: Te sfidat 'kapacitetet njerëzore', siç është, mendoj që duhet me qenë 'burimet njerëzore, resurset humane', pra, duhet me e ba këtë zëvendësim... Mendoj që duhet të bëhet...

Alban Krasniqi: Nëse nuk vendoset 'që ka mungesë të aftësive profesionale' nuk e votoj këtë raport, nuk angazhohem, jemi pajtuar, ndërsa janë ndryshua...Veç numrit, këta janë të paaftë me u angazhue,

me ju përgjigj sfidave në aspektin profesional...Doni të thoni kështu, mirë, nuk doni me kuptua... Le ta vendos votim, jo individ...

E potencova edhe herën e kaluar, se nuk është mungesa e stafit, por janë të pa aftë profesionalisht. Nuk jam këtu për plotësim të të drejtave humane, sociale! Mbivendosjet çështjet individuale, në vend të atyre profesionale! Këtyre njerëzve u kemi dalë hakut, nuk mundesh me i mbijetua mos punës...

Unë, nuk marrë pjesë në diskutim...

Ilir Gashi: Unë, edhe në mbledhjen e kaluar propozova. Ligji ka ndryshue, dhe e dimë se cilat janë ndryshimet. Ky institucion, me gjithë defektet, është cilësuar si nga institucionet më të mira. Ndryshimet kanë të bëjnë me plotësimin e resurseve. Unë, ju baj thirrje që ai formulim nuk duhet me kanë, sepse nuk ka logjikë, nuk ka moral...! Ne, mandej nuk kemi arsye me qenë ma këtu, as si Sekretariat dhe as si KQZ.

Kreshnik Radoniqi: Unë, nuk jam me e lanë këtë formulim. E votojmë, edhe shohim...

Në vazhdim Valmir Elezi, paraqiti në formë shpjegimesh plotësimet, sfidat dhe inkorporimet e rekomandimeve të reja në raport. Pjesët e ndryshuara, të gjitha janë me ngjyrë të kuqe...

Sami Kurteshi, tha se ka ende lëshime gjuhësore e teknike. Do t'ua dërgoj me imell. Mirëpo, ai bëri vërejtje në fq, 12 - rregullimi i tabelave, në fq. 18 - disproporcioni mes tekstit – paragrafëve dhe tabelave, fq. 22 – fotografitë të rregullohen, fq, 23 – çështja e paragrafit – përmbajtja nuk është e përputhshme në strukturë të mendimit, fq. 27 – thuhet se duhet të punësohen 14 zyrtar të ri në Sekretariat dhe 12 në Zyrën për Regjistrim të Partive... A janë llogaritur mirë...? A janë 26 persona, apo nuk janë? Nëse është në rregull, mirë s'kam asgjë...

Burim Ahmetaj, shpjegoi dhe tha se, kjo është në rregull...

Sami Kurteshi, vazhdoi edhe më tutje me sqarimet, me pyetjet dhe me analizat e propozimet e tij për raportin, dhe tha se 'sfidat dhe rekomandimet' janë më mirë se në versionin e kaluar. Shiheni edhe ju tekstin se a ka nevojë që secila sfidë të ketë edhe rekomandim...

Në diskutim, morën pjesë edhe më tutje gjerë e gjatë: Fazli Stollaj, Kreshnik Radoniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Gordana Llaban, Sami Kurteshi, Ibrahim Selmanaj dhe Čemailj Kurtiš.

Në diskutime, u tha se duhet ba edhe më tutje përpjekje që "resurset njerëzore - profesionale të shtohen, të rriten.

Kreshnik Radoniqi: Me këtë formulim, e hedh në votim, kështu si është, e hedh në votim.

Me 8 vota për, dhe 2 abstenime, u miratua raporti për Kuvendin e Kosovës.

3. Shqyrtimi dhe rekomandimi për ndërprerjen e mandatit të KKZ-vë në komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovica e Veriut.

Burim Ahmetaj: Sekretariati e ka sjellë këtë rekomandim, sepse kanë përfunduar procedurat. Pra, të ndërpritet mandati më 8 maj, meqë janë përmbyllur të gjitha procedurat.

Me 10 vota për, u miratua ky rekomandim i Sekretariatit

4. Raport i Këshillave të KQZ

Këshilli për Personel

Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e ekuivalencës së pagave të pozitive të reja të krijuara në KQZ, dhe shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e shtesës tranzitore:

Alban Krasniqi: Materialet i keni pranua në imell. Janë dy vendime: caktimin e ekuivalencës së pagave të pozitive të reja të krijuara në KQZ, dhe caktimin e shtesës tranzitore. Vendimi i parë, është hartue në bashkëpunim me konsulentin Naser Shamolli.

Me këto dy vendime, mendoj se nuk ka çështje të pazgjidhur në këto aspekte këtu, në institucionin tonë, tha z. Krasniqi. Kemi pritur sot edhe raportin e strukturës së organigramit, mirëpo nuk kam qëndrim. Mund ta votojmë, vlerësojeni ju...

Arianit Elshani, tha se mund të kaloj sot kjo, por mbledhja e ardhshme e KQZ nuk duhej të fillonte pa e pas në agjendë këtë raport...

Me 11 vota për, u miratua caktimin e shtesës tranzitore.

Kreshnik Radoniqi: Kërkësën e Valmirit, unë ende nuk jam duke e kuptue ! Kjo, nuk ka të bëjë vetëm me një person...

Alban Krasniqi, tha se, ende nuk e kemi të qartë, sepse ne nuk mund të marrim vendim ta zëmë, ende për personat që si kemi. Dy zyrtarët që i kemi, duhet të na shpjegojmë detajisht...

Kreshnik Radoniqi: Kemi rast kur, asht marrë një vendim, e kam marrë një vendim për drejtorin unë si kryesues por kurrë nuk asht ekzekutua! Nuk dua të merret një vendim që nuk ekzekutohet, dua ta shoh vetë njëherë këtë çështje...

Arianit Elshani, tha se ligji për paga parasheh disa mundësi, nuk është vetëm kjo e shtesës pa orarë të paracaktuar, por janë shtesat për vëllimin e punës etj. Por, vendimi duhet të ketë qartësi...Si zyra ligjore edhe si KQZ, duhet ta dimë saktë se ku, qysh, pse dhe si realizohet...

Nuk po shoh anëtarë të KQZ që është kundër, por thjeshtë duhet interpretim të saktë, të qartë...

Ilir Gashi: As si japim dhe as si marrim askujt asgjë, por ligji e jep. Kryetar ju trajtojani këtë kërkesë që nuk është vetëm për një individ, por edhe për persona tjerë. Merrreni këshillën ligjore, rregullën, ligjin dhe...